

06/11/2023

## **LETËR FALENDERIMI E PATRIARKUT TË JERUZALEMIT THEOFIL PËR KRYEPISKOPIN E SHQIPËRISË, ANASTAS**



Patriarku Theofil i Jeruzalemit dërgoi një letër duke falënderuar Kryepiskopin e Shqipërisë, Anastasin, për mbështetjen që ai ofroi në lidhje me armiqësitë që shpërthyen në Lindjen e Mesme.

Patriarku Theofil tha se Kryepiskopi i Shqipërisë “punoi më shumë se kushdo tjetër” për përgatitjen dhe mbledhjen e Sinodit të Madh të Orthodhoksisë në Kretë, duke mbrojtur me dialog vëllazëror me kishat e tjera orthodhokse privilegjet e Patriarkanës Ekumenike dhe të Sinodalitetit të Kishës Orthodhokse”.

Ai shtoi se “edhe tani me këmbëngulje dhe me shqetësim po bën përpjekje të palodhura me bashkëpunimin e kishave të tjera orthodhokse për shërimin e unitetit të ndarë të Kishës Orthodhokse në Krisht”.

[Radio “Ngjallja”](#)